

V E N D I M
Nr. 564, datë 13.11.2002

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË RUMANISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN SANITARE VETERINARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare" me propozimin e Zëvendëskryeminitrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Rumanisë për bashkëpunimin në fushën sanitare veterinarë.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË RUMANISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN SANITARE VETERINARE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Rumanisë, më poshtë të quajtura Palë Kontraktuese;

Marrin vendim për të zgjeruar dhe zhvilluar bashkëpunimin reciprok në fushën e veterinarisë;

Me qëllim që të sigurojnë një mbrojtje të përshtatshme kundër sëmundjeve të kafshëve dhe atyre të shkaktuara prej produkteve me origjinë shtazore, të karakterizuara nga një shëndet jo i mirë;

Të prirura nga dëshira për të zhvilluar më tej lidhjet midis dy vendeve, për të lehtësuar tregtinë e ndërsjellë të kafshëve, materialit biologjik artificial, embrione, vezë për riprodhimin, produkte me origjinë shtazore, ilaçe dhe produkte të tjera, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin e kafshëve;

Vendosën të lidhin këtë Marrëveshje.

Neni 1

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë lidhur me mbrojtjen e territoreve të shteteve të tyre kundër transmetimit të sëmundjeve të kafshëve gjatë importit, eksportit dhe tranzitit të kafshëve, materialit biologjik artificial, embrione, vezë për riprodhim, produkte me origjinë shtazore, ilaçe dhe produkte të tjera që mund të ndikojnë në shëndetin e kafshëve.

Neni 2

Autoritetet sanitare veterinarë të Palëve Kontraktuese kompetente në zbatim të kësaj konvente janë si vijon:

1. Drejtoria Veterinarë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit e Republikës së Shqipërisë.

2. Agjencia Kombëtare Sanitare Veterinare e Ministrisë së Bujqësisë së Rumanisë.

Neni 3

Autoritetet kompetente sanitare veterinare të Palëve Kontraktuese do të bien dakord mbi aktivitete të përbashkëta, me qëllim që të thjeshtojnë ekzekutimin e procedurave sanitare veterinare për importimin, eksportin dhe tranzitin e kafshëve, materialit biologjik artificial, embrioneve, vezëve për riprodhim, produkteve me origjinë shtazore, barnave dhe produkteve të tjera për përdorim në mjekësinë veterinare, ushqimeve të blegtorisë dhe produkteve të tjera që i nënshtrohen kontrollit sanitar veterinar në kufi. Aktivitetet dypalëshe do të aprovohen duke marrë në konsideratë rregullat e legjislacionit shqiptar dhe rumun, si dhe ato të Bashkimit European dhe OBT-së.

Neni 4

Autoritetet sanitare veterinare kompetente do t'i japin njëri-tjetrit informacionin mbi:

a) gjendjen në territoret e shteteve të tyre, të sëmundjeve të specifikuara në listën A të Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive duke përfshirë emrin e specieve, numrin e kafshëve të prekura nga sëmundjet dhe zonat e përhapjes së sëmundjeve, bazën për diagnozën dhe veprimtaritë e ndërmarra me qëllim që të kontrollohen sëmundjet;

b) sëmundjet infektive të kafshëve, të specifikuara në listat A dhe B të Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive, duke shkëmbyer çdo muaj buletinet;

c) kushtet sanitare veterinare dhe modelet e certifikatave sanitare veterinare, që përcaktojnë kushtet e importit, eksportit dhe tranzitit të kafshëve, materialet biologjike artificiale, embrione, vezë për riprodhim, produkte me origjinë shtazore, barna dhe produkte të tjera për përdorim në mjekësinë veterinare, ushqime për blegtorinë dhe produkte të tjera, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin e kafshëve.

2. Autoritetet kompetente sanitare veterinare të Palëve Kontraktuese do të informojnë njëri-tjetrin, menjëherë, mbi masat e prandalimit të ndërmarra në rast të sëmundjeve të specifikuara në listën A të Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive që ndodhin në territoret e vendeve fqinjë.

Neni 5

1. Palët Kontraktuese do të mbështesin bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente veterinare dhe institucioneve shqiptare dhe rumune, që shfrytëzojnë arritjet shkencore dhe teknike në fushën sanitare veterinare përmes:

a) shkëmbim përvoja dhe njohurie në lidhje me çështjet e profesionit veterinar;

b) shkëmbim informacioni dhe vizita pune të bëra nga personeli shkencor dhe specialist;

c) shkëmbim i revistave profesionale dhe i botimeve të tjera sanitaro-veterinare;

d) shkëmbim informacioni në lidhje me aktivitetet sanitaro-veterinare, akte ligjore, rregullat dhe rregulloret e botuara në këtë fushë;

e) shkëmbim informacioni, rregulloresh dhe specialistësh në fushën e përpunimit, kontrollit, regjistrimit dhe tregtimit të produkteve veterinare.

2. Palët Kontraktuese do të lejojnë autoritetet e tyre kompetente veterinaro-sanitare të kryejnë kontrole të ndërsjella në qendrat e eksportimit të kafshëve, materialit biologjik artificial, embrione, vezë për riprodhim, produkte me origjinë shtazore, barna dhe produkte të tjera për përdorim në mjekësinë veterinare, ushqimeve për blegtorinë dhe produkte të tjera, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin e kafshëve.

Neni 6

Shpenzimet në zbatim të klauzolave të kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen prej secilës Palë Kontraktuese, duke respektuar legjislacionin e tyre.

Neni 7

1. Përfaqësuesit e autoriteteve kompetente veterinaro-sanitare të Palëve Kontraktuese do të takohen sa herë që të jetë e nevojshme në vendin dhe kohën që do të bien dakord në mënyrë të ndërsjellë.

2. Çdo marrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet përmes bisedimeve të Palëve Kontraktuese.

3. Në rast se mirëkuptimi nuk është arritur gjatë bisedimeve të përmendura në pikën 2, mospërputhjet ndërmjet Palëve Kontraktuese në zbatimin e Konventës do të shqyrtohen nga një komision i përbashkët. Komisioni do të përbëhet nga dy veterinerë dhe një jurist nga secila Palë Kontraktuese.

Komisioni do të takohet me kërkesën e njëres nga Palët Kontraktuese brenda 30 ditëve nga data e kërkuar për një takim të tillë nga njëra nga Palët Kontraktuese, në territorin e vendit të vet. Takimi do të drejtohet në mënyrë të alternuar nga një anëtar i secilit delegacion.

Neni 8

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rezultojnë prej marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të përfunduara nga Palët Kontraktuese në fushën veterinaro-sanitare.

Neni 9

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e 60-të pas datës së fundit të njoftimit të fundit përmes të cilit Palët Kontraktuese do të informojnë njëri-tjetrin për përfundimin e procedurave të kërkuara nga legjislacioni i tyre për të hyrë në fuqi.

Neni 10

Kjo Marrëveshje është bërë për një periudhë 5-vjeçare dhe do të zgjatet automatikisht për një periudhë të re 5-vjeçare, në qoftë se njëra nga Palët Kontraktuese nuk njofton Palën tjetër Kontraktuese të paktën 6 muaj para skadimit të vlefshmërisë së periudhës përkatëse rreth qëllimit të saj për të përfunduara Marrëveshjen.

Neni 11

Në datën që kjo Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë do të hyjë në fuqi, konventa veterinaro-sanitare ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Socialiste të Rumanisë, e nënshkruar në Tiranë më 22 mars 1975, humbet vlefshmërinë e saj.

Nënshkruar në Bukuresht më 6.12.1999, në dy kopje origjinale secila në shqip, rumanisht dhe anglisht, të gjitha tekstet duke qenë në mënyrë të barabartë autentike.

Në rast ndryshimi në përkthim, teksti anglisht do të ketë prioritet.